



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Në mbështetje të nenit 38, paragrafi 2, 39 paragrafi 16, Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE	
REGULATIVNI AUTORITET ŽELEZNICA	
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY	
DEP/SEK. DEP/SEK. DEP/SEK.	NR PROT. BR. PROT. NR. PROT.
01	122
NUMRI I FAQEVE BROJ STRANA NR OF PAGES	DD.MM.VVVV: DD.MM.GGGG: DD.MM.YYYY:
11	02/06/2024
PRISHTINË / A	

**Rregullore Nr. 02/2020 për Taksa dhe Gjoha për Plotësim Ndryshimin e Rregullores
Nr. 01/2017**

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i Rregullores është përcaktimi i rregullave dhe procedurat për realizimin e taksave dhe vendosjen e gjobave nga ARH-ja. Me këtë Rregullore, ARH definon shumën fikse të taksave në fushën e Licencimit, Sigurisë, Rregullimit të Tregut dhe Interoperabilitetit, si dhe përcaktimin e shumës fikse të gjobave për personat juridik dhe fizik.

Plotësim ndryshimi i kësaj Rregulloreje bëhet me qëllim të harmonizimit të gjobave me Ligjin Nr. 06/L-067 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjitha llojet e të hyrave të cilat gjenerohen si rezultat i gjobave, taksat për: aplikacion dhe marrje të licencës, aplikacion dhe marrje të autorizime të sigurisë, aplikacion dhe marrje të certifikatës së sigurisë, aplikacion dhe marrje të autorizime të futjes në shërbim për mjetet e reja, aplikacion dhe marrje të autorizime të futjes në shërbim për mjetet e riparuar, aplikacion dhe marrje të autorizime të futjes në shërbim për infrastruktur, aplikacion dhe regjistrim të mjeteve lëvizëse, aplikacion dhe ri-regjistrim/modifikim të mjeteve lëvizëse, aplikacion dhe marrje të kodit të VKM (shenjëzimi i mbajtësit të mjetit lëvizës), etj.

Neni 3 Definicionet

‘**gjobë**’ nënkuptojnë të gjitha gjobat apo ndëshkimet të parapara nga neni 143 i ligjit për hekurudhat e Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-063 si dhe Aneksin II të kësaj rregullore;

‘**licencë**’ nënkupton licencë për Menaxherin e Infrastrukturës, Ndërmarrjet Hekurudhore, dhe Makinistët;

‘**autorizim i sigurisë**’ nënkupton autorizimi i sigurisë për Menaxherin e Infrastrukturës;

‘**certifikatë e sigurisë**’ nënkupton certifikata e sigurisë për Ndërmarrjen Hekurudhore;

‘**autorizimi i futjes në shërbim**’ nënkupton autorizimin për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse dhe infrastrukturës;

‘**regjistrim i ri**’ nënkupton regjistrim e mjetit lëvizës hekurudhore për herë të parë nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave dhe përfshirja e tij në Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse NVR (Nacional Vehicle Registration);

‘**modifikim/ri-regjistrim**’ nënkupton çfarëdo veprimi i cili do të ndikojë në modifikimin e njërës apo më shume pikave në formularin e regjistrimit;

‘**tërheqje**’ nënkupton tërheqjen nga komunikacioni të mjetit lëvizës hekurudhore;

‘**kodi i VKM (Vehicle Keeper Marking)**’ një kod që përbëhet nga 2 deri në 5 shkronja që është përfaqësimi i emrit të plotë apo shkurtim i mbajtësit të mjetit lëvizës hekurudhore.

Neni 4 **Lartësia e gjobave**

Lartësia e gjobave do të jetë ajo e paraparë me ligjit për hekurudhat e Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-063, respektivisht neni 143, si dhe e detajizuar në Aneksin II të kësaj rregullore.

Neni 5 **Inkasimi i të hyrave**

Inkasimi i të hyrave nga ARH-ja të cilat vijnë si rezultat i gjobave dhe taksave do të bëhet konformë dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë.

Neni 6 **Shfrytëzimi i të hyrave**

ARH do të shfrytëzoj të hyra e realizuara nga gjobat ose taksat e caktuar, në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike në Republikën e Kosovës si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë.

Neni 7 **Procedurat**

Procedurat për realizimin e të hyrave të ARH-së do të bëhet në bashkëpunim dhe koordinim me Ministrin e Financave, konformë Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë.

Neni 8 **Ekzekutimi i gjobës**

Ekzekutimi i gjobës duhet të bëhet në afat prej 30 ditësh nga ana e subjektit të gjobitur.

Neni 9

Ankesat

- 1.Kundër vendimit të ARH-së për shqiptimin e gjobës është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e shqiptimit të gjobës.
- 2.Shqyrtimin e Ankesave e bën Bordi Mbikëqyrës i ARH-së, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të Ankesës.
- 3.Kundër vendimit të Bordit nuk është e lejuar ankesa brenda ARH-së.
- 4.Nëse nuk përdoren mjete tjera juridike kundër vendimit të Bordit në gjykatën kompetente, ekzekutimi i gjobës duhet të bëhet brenda 30 ditësh nga data e marrjes së vendimit nga ana e Bordit të ARH-së.

Neni 10 Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.


Kryesues i Bordit të ARH-së
Prishtinë, 27.02.2020



Aneksi I

1. Lisat e taksave për aplikime dhe licenca tek Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

1.1 Taksat e aplikacionit për licencë

Nr.	Llojet e aplikacioneve	Shuma
1	Aplikacion për Licencë për Menaxher të Infrastrukturës	250 €
2	Aplikacion për Licencë për Ndërmarrje Hekurudhore	250 €
3	Aplikacion për Licencë të Makinistit	50 €
4	Aplikacion për Ripërtëritje të Licencës së Makinistit	50 €

1.2 Taksat e licencës

Nr.	Llojet e licencave	Shuma
1	Licencë për Menaxher të Infrastrukturës	8000 €
2	Licencë për Ndërmarrje Hekurudhore	5000 €
3	Licencë të Makinistit	200 €
4	Ripërtëritje të Licencës së Makinistit	100 €

2. Lista e Taksa për aplikacion dhe Autorizim, Certifikatë të Sigurisë si dhe Autorizim për Futje në Shërbim

2.1

Nr.	Llojet e aplikacioneve	Shuma
1	Aplikacion për Autorizim të Sigurisë për Menaxher të Infrastrukturës	250 €
2	Aplikacion për Certifikatë të Sigurisë për Ndërmarrje Hekurudhore	250 €
3	Aplikacion për Futje në Shërbim për mjetet e reja	150 €
4	Aplikacion për Futje në Shërbim për mjetet e riparuar	100 €
5	Aplikacion për Futje në Shërbim për Infrastruktur të re	150 €

2.2

Nr.	Llojet e taksave për Autorizim/Certifikatë të sigurisë dhe Autorizimi i futjes në shërbim	Shuma
1	Autorizim të Sigurisë për Menaxher të Infrastrukturës	6000 €
2	Certifikatë të Sigurisë për Ndërmarrje Hekurudhore	4000 €
3	Futje në Shërbim për mjetet e reja (1 % nga vlera e blerjes)	1 %
4	Futje në Shërbim për mjetet e riparuar (1.5% nga vlera e riparimit)	1.5%
5	Futje në Shërbim për Infrastrukturë të re (1 % nga vlera e blerjes së nënsistemit)	1 %
6	Renovimi i Autorizimit të Sigurisë për Menaxherin e Infrastrukturës	1000 €
7	Renovimi i Certifikatës së Sigurisë për Ndërmarrjen Hekurudhore	1000 €

3. Lista e Taksave për Aplikim dhe Regjistrim të Mjeteve Lëvizje

Nr.	Llojet e aplikacioneve	Shuma
1	Aplikacion për Regjistrim të Mjeteve Lëvizëse	50 €
2	Aplikacion për Ri-regjistrim/Modifikim të Mjeteve Lëvizëse	50 €
3	Aplikacion për Tërheqje	50 €
4	Aplikacion për Kodin e VKM (Shenjëzimi i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës	50 €

3.1

Nr.	Llojet e aplikacioneve	Shuma
1	Regjistrim të Mjeteve Lëvizëse	150 €
2	Ri-regjistrim/Modifikim të Mjeteve Lëvizëse	100 €
3	Tërheqje	100€
4	Kodi i VKM (Shenjëzimi i Mbajtësit të Mjetit Lëvizës	200 €

Aneksi II

Gjobat fikse për shkelje të ligjit të hekurudhave në kuptim të nenin 143 nga personat juridik dhe fizik.

Nr.	<ul style="list-style-type: none"> - Personi juridik për kundërvajtje (shkelje administrative) sipas nenit 143 paragrafi 1 gjobitet prej 3000-8000 Euro. - Personi përgjegjës i personit juridik apo personi fizik për kundërvajtje (shkelje administrative), sipas Nenit 2 paragrafi .1.1. të Ligjit nr. 06/L-067 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, gjobitet prej 1000-2000 Euro. 	Gjoba	
		Personi Juridik	Personi Fizik
		3.000-8.000	1.000-2.000
1	Menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët, ndërmarrjet hekurudhore apo cilado pale tjetër nuk i ofron Organit Rregullativ të Tregut informacionin e kërkuar (sipas paragrafit 6 të nenit 26 të këtij ligji)	3000 €	1000 €
2	Menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët nuk e publikojnë Ekspozeun e rjetit sipas kriterëve të përcaktuara (neni 55 i këtij ligji)	8000 €	1000 €
3	Menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët nuk e njoftojnë Organin Rregullativ të Tregut për zbritjen e çmimit (neni 67 paragrafi 3 i këtij ligji)	6000 €	1000 €
4	Menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët bëjnë rezervime të traseve të infrastrukturës pa përfill procedurat e përcaktuara (në nenin 69 të këtij ligji)	3000 €	1000 €
5	Të hyrat e krijuara nga qasja në binarë nuk regjistrohen dhe bëhen publike (neni 70 i këtij ligji)	6000 €	1000 €
6	Orari i alokimit të kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 77 të këtij ligji	3000 €	1000 €
7	Infrastruktura është deklaruar e mbingarkuar dhe nuk analizohen kapacitetet në afatin e caktuar (neni 84 paragrafi 2 i këtij ligji)	4000 €	1000 €
8	Nuk është propozuar plani për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturës nga menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët, atëherë kur infrastruktura është deklaruar e mbingarkuar dhe është kompletuar analiza e kapacitetit (neni 85 paragrafi 1 i këtij ligji)	5000 €	1000 €
9	Procesi i planifikimit të mirëmbajtjes të infrastrukturës i propozuar nga menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët është në kundërshtim me nenin 87 të këtij ligji	3000 €	1000 €
10	Nuk mbahet regjistri i licencave dhe certifikatave të sigurisë të makinistëve (neni 95 paragrafi 6 dhe 7 të këtij ligji)	4000 €	1000 €
11	Sistemet e vendosura për menaxhimin e sigurisë nuk përmbajnë	5000 €	1000 €

	elementet bazike (neni 103 paragrafi 5 i këtij ligji)		
12	Nuk është paraqitur raporti vjetor nga Autoriteti Nacional i Sigurisë deri më 30 qershor (neni 20 paragrafi 1 i këtij ligji)	5000 €	1000 €
13	Nuk është paraqitur raporti vjetor nga Organi Rregullativ i tregut deri më 30 qershor (neni 26 paragrafi 12 i këtij ligji)	6000 €	1000 €
14	Sistemet dhe nënsistemet hekurudhore nuk plotësojnë kërkesat e përgjithshme të sigurisë (neni 105 i këtij ligji)	4000 €	1000 €
15	Nënsistemet hekurudhore nuk plotësojnë kërkesat specifike të sigurisë (neni 106 i këtij ligji)	4000 €	1000 €
16	Nënsistemet hekurudhore, mjetet transportuese, instalimet, aparatet ndihmëse, pajisjet dhe shërbimet, nuk përputhen me kërkesat e sigurisë të STI-së dhe rregullat nacionale të sigurisë (neni 107 i këtij ligji)	5000 €	1000 €
17	Nuk ka deklaratën e verifikimit e cila dëshmon se nënsistemi struktural do të konsiderohet si interoperabil dhe që i plotëson kërkesat esenciale të sigurisë (neni 109 paragrafi 3 i këtij ligji)	3000 €	1000 €
18	Mjetet e transportit hekurudhor operojnë pa numrin nacional (neni 110 paragrafi 8 i këtij ligji);	3000 €	1000 €
19	Regjistri nacional i mjeteve të transportit nuk mbahet në mënyrë korrekte (neni 110 paragrafi 8 i këtij ligji);	3000 €	1000 €
20	Pas marrjes të autorizimit për vënien në shërbim të nënsistemeve strukturore menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët nuk aplikojnë për marrjen e autorizimit të rifreskuar të sigurisë (neni 111 paragrafi 1 i këtij ligji)	4000 €	1000 €
21	Pas marrjes së autorizimit për futjen e mjeteve të transportit në shërbim, ndërmarrja hekurudhore nuk aplikon për marrjen e certifikatës së rifreskuar të sigurisë (neni 111 paragrafi 2 i këtij ligji)	4000 €	1000 €
22	Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk mbajnë regjistrin me të dhënat teknike për objektet e infrastrukturës (neni 118 paragrafi 3 i këtij ligji)	3000 €	1000 €
23	Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk përgatisin planet e kërkuara të biznesit dhe dokumentet strategjike (neni 118 paragrafi 4 i këtij ligji)	5000 €	1000 €
24	Entitetet legale të cilat ndërtojnë apo rindërtojnë infrastrukturën e shfrytëzimit të përbashkët nuk i ndërmarrin masat e duhura për zhvillimin e sigurt të trafikut, apo nuk largojnë nga infrastruktura hekurudhore apo brezi mbrojtës pas kryerjes së punëve materialin e mbetur, mjetet, shenjat lajmëruese dhe objektet tjera për të siguruar transport të sigurt (neni 121 paragrafi 3 i këtij ligji)	4000 €	1000 €
25	Me kërkesën e menaxherit të infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët pronari i stabilimenteve të përcaktuara në paragrafin 7 të nenit 128 refuzon ti rregullon apo zhvendos ato (neni 128 paragrafi 9 i këtij ligji)	4000 €	1000 €
26	Organit rregullativ të tregut nuk i jepet qasje në informatën e kërkuar nga menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët dhe nga ndërmarrjet hekurudhore (neni 26 paragrafi i	5000 €	2000 €

	këtij ligji)		
27	Organi rregullativ i tregut nuk vendos për ankesat apo nuk ndërmer veprim për trajtimin e tyre brenda periudhës tre mujore të përshkruar me këtë ligj (neni 26 paragrafi 7 i këtij ligji)	3000 €	1000 €

Nr.	<ul style="list-style-type: none"> - Personi juridik për kundërvajtje (shkelje administrative) sipas nenit 143 paragrafi 3 gjobitet prej 5000-10000 Euro. - Personi përgjegjës i personit juridik apo personi fizik për kundërvajtje (shkelje administrative), sipas Nenit 2 paragrafi .1.2. të Ligjit nr. 06/L-067 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, gjobitet në shumën 2000 Euro. 	Gjoha	
		Personi Juridik	Personi Fizik
		5.000-10.000	2.000
1	Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk ndërmarrin masat adekuate në rast të çrregullimit në lëvizjet e trenave (neni 88 i këtij ligji)	7000 €	2000 €
2	Ndërmarrjet hekurudhore nuk posedojnë certifikatën e sigurisë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 94 të këtij ligji	10000 €	2000 €
3	Ndërmarrjet hekurudhore nuk i përmbahen dispozitave të këtij ligji lidhur me licencat dhe certifikatat e makinistëve (neni 95 deri 99 i këtij ligji)	5500 €	2000 €
4	Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët dhe ndërmarrjet hekurudhore nuk aplikojnë për certifikatat dhe autorizimet e tyre të sigurisë (neni 103 paragrafi 1 i këtij ligji)	8000 €	2000 €
5	Ndërmarrjet hekurudhore ofrojnë shërbime pa u pajisur me certifikatën e sigurisë (neni 104 paragrafi 1 i këtij ligji)	10000 €	2000 €
6	Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk posedojnë autorizimin e sigurisë sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 104 paragrafi 2 i këtij ligji	10000 €	2000 €
7	Sistemet e vendosura për menaxhimin e sigurisë nuk përmbajnë elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor neni 103 paragrafi 2 dhe 3 i këtij ligji)	8000 €	2000 €
8	Autoritetit Nacional të Sigurisë nuk i lejohet qasje në dokumentacion dhe objekte, instalime dhe pajisje për inspektim (neni 104 paragrafi 5 i këtij ligji)	10000 €	2000 €
9	Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët dhe ndërmarrjet hekurudhore fusin në shërbim ndonjë nënsistem të	10000 €	2000 €

	hekurudhave pa marrë autorizim nga organi përgjegjës mbi sigurinë (neni 109 paragrafi 1 i këtij ligji)		
10	Ndërmarrjet hekurudhore e fusin në shërbim mjetin e transportit hekurudhor pa autorizim dhe certifikatë adekuate (neni 110 paragrafi 1 dhe 2 i këtij ligji)	6000 €	2000 €
11	Mirëmbajtja e mjeteve të transportit hekurudhor bëhet në kundërshtim me dispozitat e nenit 112 të këtij ligji	4000 €	2000 €
12	Gjatë ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës hekurudhore nuk ofrohen informacionet dhe zgjidhjet e kërkuara për publikun (neni 121 paragrafi 1 i këtij ligji)	8000 €	2000 €
13	Pas ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk aplikojnë për autorizim të sigurisë (neni 121 paragrafi 2 i këtij ligji)	8000 €	2000 €
14	Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk e ndërtojnë infrastrukturën hekurudhore me elementet e përshtatshme (neni 122 i këtij ligji)	10000 €	2000 €
15	Pa miratimin e menaxherit të infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët, entiteteve apo personave tjerë legal, vendosen kablllo telefonike, elemente të rrjetit elektrik, gypa të ujërave etj. në brezin e infrastrukturës hekurudhore (neni 128 paragrafi 7 i këtij ligji)	10000 €	2000 €
16	Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk ndërmarrin masat e domosdoshme për mbrojtje teknike dhe fizike nga fatkeqësitë elementare (neni 128 paragrafi 12. i këtij ligji)	10000 €	2000 €
17	Entitetet legale apo personat tjerë ndërtojnë afër brezit mbrojtës të hekurudhës në kundërshtim me nenin 129 të këtij ligji	10000 €	2000 €
18	Entitetet legale apo personat tjerë ndërtojnë nënkalime, mbikalime apo vendkalime në nivel pa pëlqimin paraprak të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët	10000 €	2000 €